

Dr. Manolita Hida



Didi
rikthehet
në Kopsht



*Me shumë dashuri
Manolita*

Prindër dhe Edukatore!

Ky është një tregim i konceptuar për t'ju ardhur në ndihmë në mirë rritjen dhe mirë kujdesin për fëmijët gjatë periudhës së Covid 19.

Ndihmojini ata të kuptojnë më shumë. Lexojeni këtë tregim sëbashku me ta, dhe përshtateni sipas nevojave tuaja!

Fëmijë!

Ky tregim është për Ju!

Shihni figurat, dhe kur hasni në vështirsi pyesni më të rriturit. Nuk është gabim të pyesësh.

Didi do ju ndihmojë të kuptoni më shumë. Ai është një djalë i vogël dhe shumë kurioz, njësoj si ju.

Në fund mos harroni, ju kemi shumë xhan, edhe pse nuk mund t'ju përqafojmë.

Didi ishte i lumtur. Ai
do të rikthehej në
Kopësht.




Pas një kohe të gjatë qëndrimi në shtëpi,
Didi e priste me shumë gëzim rikthimin
në kopsht.

Sëbashku me mamanë e tij, Didi,
përsëriti rregullat që duhej të respektonte
në kopsht për tu ruajtur nga përbindëshi i
vogël me emrin Korona ose Covid-19.



Gjatë kohës së
qëndrimit në shtëpi, Didi
kishte dëgjuar se vende
të ndryshme ishin
infektuar nga Covid-19.
Ai dhe familja e tij i
kishin zbatuar rregullat
dhe nuk ishin infektuar.



Mëngjesi erdhi!

Didi u nis për në kopsht në orën: _____



Në kopsht Didi mund të shkonte vetëm me mamin ose babin, por jo me gjyshërit, pasi rreziku për ta, nuk kishte kaluar ende.




Kur Didi arriti në kopsht, ai sëbashku më babain e tij, respektuan largësinë nga fëmijët e tjerë dhe prindërit e tyre.




Prindërit ishin me maska dhe doreza.

Didi pa se dhe edukatorët ishin me maska dhe doreza. Edukatorja e mirë priti dhe e shoqëroi tek mjeku për të matur temperaturën dhe për të dezinfektuar duart para se të hynte në kopsht. Didi dezinfektoi dhe këpucët tek qilimi me klor.

Në hyrje të kopështit, ishte xhaxhi Doktorin me termometrën dhe xhelin dezinfektues për duart. Didi mati temperaturën dhe më pas dezinfektoi duart me xhel.




Didi, duhej t'i tregonte xhaxhi doktorit ose edukatores nëse nuk do të ndihej mirë:



Kollë




Temperaturë



Probleme me frymëmarrjen



Fyt të tharë dhe rrjedhje hundësh





Kujdes!

Edukatorja i tha Didit se brenda në kopsht, nuk mund të përqafohet apo preket me fëmijët e tjerë, por Didi e dinte këtë sepse e kishte mësuar me mamin në shtëpi.

Didi i kërkoi edukatores që t'ja spjegonte rregullat edhe shokëve të tij të vegjël.

Edukatorja pranoi. Të dy shkuan pranë fëmijëve të tjerë.

Didi: Ej fëmijë, a e mbani mend përbindëshin e vogël, për të cilën ju kam folur dhe më parë?

Tani do ta kujtojmë bashkë se çfarë kemi thënë për të:

- ▶ **Korona Virusi është një virus si përbindësh i vogël i cili mund të bëjë që ne të mos ndihemi mirë.**



**Unë jam Korona Virusi,
dhe sapuni është armiku
im!**

**Sa më shumë ai shkumon
dhe sa më shumë ai lan aq
më i dobët bëhem unë
derisa zhdukem fare.**

Fëmijët u kujtuan për armikun e padukshëm. Ata po e dëgjonin me shumë vëmendje Didin.

Didi u tha fëmijëve, se tani ata nuk mund të ulen pranë njëri-tjetrit në tavolinë, por duhet të rrinë një karrige larg, për tu mbrojtur nga virusi.



Didi u tha fëmijëve se ata nuk mund t'ja japin ende dorën njëri-tjetrit, edhe pse i ka marrë malli. Ai gjithashtu u tha fëmijëve:

**Duhet të lajmë
duart
vazhdimisht me
sapun.**

Në oborr, duhet të rrimë
larg njëri-tjetrit.





***Didi: Unë kam
mësuar edhe një
gjë të re, në shtëpi.
Si t'i lajmë duart,
hajdeni të më
shikoni mua, dhe
pastaj mund t'i
lajmë sëbashku
duart.***


Didi: A e dini se si janë duart tona plot me mikrobe? Shikojeni figurën më poshtë. Prandaj ne duhet të lajmë duart dhe të fërkojmë mirë midis gishtave. Mund të përdorim sapunin ose higjenizuesin.




20 sekonda

***Lajini duart kështu, për 20 sekonda.
Mund të themi një vjershë ose një këngë që na pëlqen ndërsa pastrojmë duart nga mikrobet.***

Në fund duhet t'i shplajmë duart me shumë ujë. Dhe ja, mikrobet ikin!



Gjithashtu kur tështijmë ose kollitemi, duhet të tregohemi të kujdesshëm.



Përdorim brrylin që të mos infektojmë të tjerët



Në të dyja rastet lajmë duart.

Përdorim kartopecetë



Pas përdorimit e hedhim në kosh.



1. Didi: Ne nuk duhet të prekim fytyrën me duar, nuk duhet të fusim gishtat te hunda, nuk duhet të prekim sytë dhe as gojën!




2.

Didi: Miqtë tanë më të mirë, janë sapuni dhe dezinfektuesi. Prandaj i lajmë duart për 20 sekonda.



Edukatorja: Kur ju të ikni në shtëpi, do vi xhaxhi që të dezifektojë kopshtin nga mikrobet, dhe ne do jemi gati që të vijmë sërish ditën tjetër.

Kopshti do jetë pastruar nga mikrobet!




Edukatorja: Kur ta kemi mundur virusin, ne do dalim të luajmë të gjithë bashkë në oborr, dhe do mund të përqafojmë njëri-tjetrin.

Të lumtë Didi, për të gjithë ndihmën që më dhe për t'i treguar dhe fëmijëve të tjerë se si duhet të sillemi në kopësht!



Derisa të mundin virusin ata duhet të zbatojnë të gjitha këshillat, të qëndrojnë larg njëri-tjetrit dhe të mos shkojnë tek grupet e tjera.



Didi dhe fëmijët e tjerë ndjehen të qetë. Ata e dinë se si të sillen për të mundur virusin.

Ata mund të pyesin edhe Edukatoren kur nuk kuptojnë rregullat.



Ky punim u realizua nga Dr. Manolita Hida - Psikologe Klinike, Zhvillimi dhe Marrëdhëniesh.

e-mail: hidamanolita@gmail.com

Publikoi: Shoqata për Shërbime Psiko-Sociale “Të Dëgjoj 366”. Të gjitha të drejtat i rezervohen autores

Fotot dhe imazhet grafike: world wide web, Pinterest, Vectorstock, Free powerpoint templates

Bazuar në Udhëzimin e publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Kontakte: E-mail: judegjoj366@gmail.com

Cel +355 698554287 Lagja “Emin Matraxhiu”, Rr. “Besim Qorri”, Pallati përballë portës D të stadiumit Elbasan Arena, Elbasan, Shqipëri.



web: <https://tedegjoj366.al/>



Facebook: Shërbime Psikologjike Të Dëgjoj 366



Instagram: [te_degjoj_366](https://www.instagram.com/te_degjoj_366)

Për donacione në favor të Shoqatës për Shërbime Psiko-Sociale dhe për të mbështetur veprimtarinë e saj, ju mund të kontribuoni në llogarinë bankare: 00013562221 Raiffeisen Bank me numër nipti: L82928331R .

E drejta e autorit

©Çdo riprodhim i plotë ose i pjesëshëm i këtij punimi nga çdo psikolog apo profesionist tjetër, çdo përdorim i të dhënave apo i bazës së të dhënave të përdour në përmbajtje të tij, çdo imitim në strukturë ose në përmbajtje, përbën shkelje të standartit 8.11 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë në Republikën e Shqipërisë (Maj 2017) dhe është shkak për nisjen e procedimit disiplinor.

Ky punim është një “vepër shkencore” nga ato që parashikohet në nenin 7/b të Ligjit Nr.9380/28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të “. Çdo cënim i të drejtës së autorit në lidhje me këtë vlerësim, pa lejim paraprak të autores, dënohet.

Manolita HIDA



Për pyetje mund të kontaktoni
në adresën e e-mailit:
hidamanolita@gmail.com

Të dhëna mbi autoren

Dr. Manolita Hida ka përfunduar studimet e larta në drejtimin Psikologji, fillimisht në nivelin Bachelor në vitin 2009, më pas në Master Shkencor në drejtimin “Psikolog Klinik, Zhvillimi dhe Marrëdhëniesh” në vitin 2011, e në Qershor të vitit 2018 mbyll studimet doktorale pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale .

Prej tetë vitesh punon si Asistente në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan , në departamentin e Psikologjisë, dhe prej gjashtë vitesh Universitetin e Tiranës , pranë departamentit Psikologji-Pedagogji. Si psikologe është angazhuar , kryesisht në rastet e fëmijëve pranë qendrës “Bethany”-Tiranë, dhe shtëpisë së Foshnjës “Hana dhe Rozafa”, Tiranë në vitin 2011.

Ka qenë pjesë e një sërë trajnimesh, me fokus problematikat sjellore dhe emocionale si dhe intervenimi i tyre (Njohja me terapinë njohëse të sjelljes; teknikat për menaxhimin e sjelljeve agresive; prezantime me raste konkrete; analiza e sjelljes së aplikuar; Trajnimi mbi “Kutitë e ëndrrave” në kuadër të projektit “Të bëjmë art aty ku është e vështirë të flitet” si mbështetje në sistemin e Burgjeve në Shqipëri mbi menaxhimin e emocioneve dhe ndjenjave të fokusuara në të pandërgjegjshme; “Çrregullimet e Zhvillimit dhe Aftësimi Akademi”, “Vlerësimi dhe trajtimi i fëmijëve që vuajnë nga Autizmi”, Terapia ABA, Sistemi PECS; etj.). Njëkohësisht ka realizuar edhe “Kursin Bazik të Psikodiagnostikës, përmes së cilës zotëron aftësitë për aplikimin dhe interpretimin e instrumentave dhe testeve matëse për Zhvillimin emocional, Testet e Inteligjences joverbale, Testet Bender – Gestalt. Gjithashtu aplikimin dhe interpretimin e testit HTP, Testi TAT dhe CAT etj. Është angazhuar në konferenca të ndryshme, duke sjellë në vëmendje shkencore, problematika aktuale. Aktualisht punon si terapiste për fëmijë.